



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh. A.), Zona Kadastrale Kryshevc, Komuna Obiliq dhe Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh. A.)
5. Kompensimi i pronave të pronarëve që shpronësohen, shpenzimet e procedurës së shpronësimit, vlerësimit dhe të gjitha obligimet tjera që mund të rrjedhin nga proceset administrative dhe gjyqësore do të bëhen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh. A.) dhe buxheti i saj.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

Komuna Fushe Kosove		Z.K. Fushe Kosove		
GJENDJA E VJETËR				
Nr.	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura, Klasa	Sipërfaqja [m2]
1	Jeriq Ivan (Bernard)	25-1	Are e Klases 1	26405
	P.SH.KBI Kosova Export-N.SH. BUJQSIJA	25-2	Are e Klases 3	24148
2	Bullatoviq (Radulla) Vuksan Bulatoviq (Radule) Svetozar Bulatoviq Joka ((Nikola) RODJ.Shqep anoviq (UD)	24-0	Are e Klases 3	60262

Komuna Fushe Kosove					Z.K. Fushe Kosove	
GJENDJA E RE						
Nr	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura, Klasa	Sipërfaqja e mbetur [m2]	Sipërfaqja për shpronësim [m2]	Vërejtje
1	I deritan ishmi					Mungon ndarja Grafike
	KEK SH.A	25-1	Are e Kl.1		26405	
	I deritan ishmi					
	KEK SH.A	25-2	Are e Kl.3		24148	
2	I deritan ishmi					
	KEK SH.A	24-0	Are e Kl.3		60262	

3	Filipovic Milovan	23-1	Are e Klases 2	20100	3	I deritan ishmi	23-6	Are e Kl.2	3688	Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	23-7		16412	
4	P.SH.KBI Kosova Export-N.SH. BUJQSIJA	23-3	Are e Klases 3	5000	4	I deritan ishmi	23-8	Are e Kl.3	4541	Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	23-9		459	
5	P.SH.KBI Kosova Export-N.SH. BUJQSIJA	23-4	Are e Klases 3	3500	5	I deritan ishmi		Are e Kl.3		
						KEK SH.A	23-4		3500	
6	Deniq Petar (Aleksandar)	23-5	Are e Klases 3	3500	6	I deritan ishmi	23-10	Are e Kl.3	1333	Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	23-11		2167	
7	P.SH.KBI Kosova Export-N.SH. BUJQSIJA	48-1	Are e Klases 4	73135	7	I deritan ishmi	48-3	Are e Kl.4	23789	Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	48-4		49346	
8	P.SH.KBI Kosova Export-N.SH. BUJQSIJA	48-2	Are e Klases 4	7005	8	I deritan ishmi		Are e Kl.4		
						KEK SH.A	48-2		7005	
9	P.SH Rrugë	840-0	Rruge e pakategorizuar	9183	9	I deritan ishmi	840-1	Rruge e pakategorizuar	6289	Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	840-2		2894	

Komuna OBILIQ Z.K. KRYSHEVC					Komuna OBILIQ Z.K. KRYSHEVC						
GJENDJA E VJETËR					GJENDJA E RE						
Nr.	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura, Klasa	Sipërfaqja [m2]	Nr.	Pronari	Nr. i Parcelës	Kultura, Klasa	Sipërfaqja e mbetur [m2]	Sipërfaqja për shpronësim [m2]	Vërejtje
1	Osmon (Osman) Pllana	443-0	Are e Klases 3	6663	1	I deritan ishmi					
						KEK SH.A	443-0	Are e Klases 3		6663	
2	Komuna e Obiliqit	577-0	Kullose e Klases 1	4214	2	I deritan					

						ishmi					
						KEK SH.A	577-0	Kullose e Klases 1		4214	
3	P.SH RRUGË	1024-0	Rruge e pakateg orizuar	49953	3	I deritan ishmi	1024-1	Rruge e pakate gorizua r	12414		Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						1024-3	20345				
						KEK SH.A	1024-2			17194	
4	Halil (Ali) Kutlovci	367-0	Kullose e Klases 2	825	4	I deritan ishmi					Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	367-0	Kullose e Klases 2		825	
5	P.SH UJËRA	356-0	Hendek	2297	5	I deritan ishmi	356-1	Hendek	1961		
						KEK SH.A	356-2			336	
6	P.SH UJËRA	342-0	Hendek	18234	6	I deritan ishmi	342-1	Hendek	10536		
						KEK SH.A	342-2			7698	
7	P.SH RRUGË	1022-0	Rruge e pakateg orizuar	6438	7	I deritan ishmi	1022-1	Rruge e pakate gorizua r	2645		
						KEK SH.A	1022-2			3793	
8	P.SH RRUGË	1023-0	Rruge e pakateg orizuar	4305	8	I deritan ishmi	1023-1	Rruge e pakate gorizua r	2812		Siperfaqja Grafike nuk perputhet me siperfaqen nga RDPP-ja (Siperfaqja eshte jashte tolerances)
						KEK SH.A	1023-2			1493	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

N J O F T I M

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe pikës Nr.4 të Vendimit të Qeverisë Nr.07/121 datë 25.01.2023, njoftohen të gjithë subjektet në listën bashkëlidhur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik dhe vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve të nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të Kosovës, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, në vijim të kërkesës së bërë nga Korporata Energjetike e Kosovës(KEK-sh.a), në zbatim të ligjit të lartpërmendur, Qeveria e Kosovës ka miratuar Vendimin **Nr.07/121 datë 25.01.2023** me të cilin aprovohet shqyrtimi i mëtejshmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit “ Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik” për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës(KEK-sh.a), Zona Kadastrale Kryshevc, Komuna Obiliq dhe Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Qeveria do të marrë një Vendim Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar, brenda 30-ditëve kalendarike, mbas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimit/ve publike.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së Vendimit të Qeverisë **Nr.07/121 datë 25.01.2023** për shqyrtimin e mëtejshmë të kërkesës për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
4. Qeveria do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e propozuar sipas kërkesës së bërë nga Korporata Energjetike e Kosovës(KEK-sh.a), Zona Kadastrale Kryshevc, Komuna Obiliq dhe Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë.

5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjendet brenda kësaj Komune ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.
6. Çdo person i lartpërmendur do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2 deri 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010.
7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (*dokumente*) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi të Interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të **Komunës së Obiliqit**, do të mbahet me datë **22 shkurt 2023, Ora 10:30, në Sallën e Kuvendit Komunal të Obiliq, përkatësisht për zonën kadastrale:**

Kryshevc

9. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të **Komunës së Fushë Kosovë**, do të mbahet me datë **23 shkurt 2023, Ora 10:30, në Sallën e Kuvendit Komunal të Fushë Kosovë, përkatësisht për zonën kadastrale:**

Fushë Kosovë

10. Në rast se prona e cila është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar në përputhje me atë kërkesë, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010.
11. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtojë Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.
12. Çdo Person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.